

## STATUT

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “EXPRESS 24 sh.p.k ”

(Hartuar ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008,“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”).

#### NENI 1

##### Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Sot me dt 10/06/2021, “**Express 24**” Sh.p.k themelohet në formën e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.
- 1.2. Emërtimi “**Express 24**” Sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.
- 1.3. Shoqeria “**Express 24**” Sh.p.k e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### NENI 2

##### Dokumentat Rregullues

- 2.1. Dokumenti kryesor mbi të cilin bazohet aktiviteti i Shoqërisë “**Express 24**” Sh.p.k është Statuti i saj. Me ane te ketij Statuti dhe ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me legjislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakëve dhe punonjesve te Shoqerise, organizimi dhe objekti i veprimtarise se Shoqerise dhe çështjet e tjera me rëndësi për aktivitetin e saj.
- 2.2 Per çështjet qe nuk zgjidhen nga Statuti, Asambleja e Ortakëve mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.
- 2.3. Statuti dhe Rregullorja e Veçantë janë dokumenta të hapura për ndryshime dhe përmirësime që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

#### NENI 3

##### Ortakët

- 2.1 Ortakët e shoqëise “**Express 24**” Sh.p.k ” jane
  1. **Klajd Mulhaxhia** person me shtetesi shqiptare , i datelindjes 07/08/1986 , mbajtes i kartes se identitetit me **nr ID I60807051B**
  2. **Bledar Sulejmani** person me shtetesi shqiptare i datelindjes 21/04/1976, mbajtes i kartes se identitetit me nr **H60421195J**
  3. **Ervin Shameti** person me shtetesi shqiptare i datelindjes 25/09/1993 mbajtes i kartes se identitetit me **nr J30925041Q**

#### NENI 4

##### SELIA



4.1. Shoqëria " **Express 24** " Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: Rruga Dibres, zona kadastrale 8370, me nr pasurie 4/126-ND ,Tirane

Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

4.2.Asambleja e Ortakëve mund të transferojë Selinë e Shoqërisë brenda teritorit te Shqipërisë.

#### **NENI 5 Kohezgjatja**

5.1. Shoqëria do te kryeje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar .

#### **NENI 6 Administratori**

6.1.Administrator i shoqërisë do te jete **Klajd Mulhaxhia me nr Id I 60807051 B**

#### **NENI 7 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

7.1. Shoqëria " **Express 24** " Sh.P.K ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Veprimtaria e Shoqërisë " **Express 24** " Sh.p.k, do të ketë për objekt

**Tregti te produkteve te ndryshme industriale. Sherbime postare. Kryerja e transporteve kombetare dhe nderkombetare te mallrave te veta dhe per llogari te te treteve. Te gjitha veprimtarite dhe sherbimet e tjera ne fushen e transporti, tregtare, financiare, ekonomike dhe te ndryshme te cilat nuk bien ne kundërshtim me kushtetuten dhe ligjet e Republikës se Shqipërisë.**

**1-Veprimtari e agjentit per transfert parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. 2-Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te trete ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke.**

**3-Veprimtari e agjentit komisioner**

**Programe per klinika dhe spitale. Programe logjistike dhe distribucioni. Platforma financiare. Website,Mobile App Android dhe IOS, Web App, Portale, Forume, Database, Ecommerce, Bussnies Marketing, Softwer Development, Sistem GPS, Paisje GPS, GIS, Suport Teknik, Mirembajtje Web, Mirembajtje Softwer, Host Srever, Domain, VPS, Erp Softwer, Mobile App development IOS. Mobile App Development Android, server i dedikuar, server VPS, server Shared.**

7.3. Shoqëria " **Ekspress 24** " Sh.p.k mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit

7.4. Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.



7.5. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj dhe emërtimin vetëm me vendim të Administratorit të saj. Vendimi i Administratorit administrohet në përputhje me legjislacionin dhe regjistrohet në QKB-se dhe në Organet Tatimore.

7.6. Shoqëria "Express 24" Sh.p.k do të ushtroje veprimtarinë për ato aktivitete që kërkojnë marrjen e licensave dhe lejeve perkatese vetëm pas marrjes së tyre nga organet dhe strukturat e caktuara nga ligji.

Shoqëria "Express 24" Sh.p.k do të ushtroje veprimtarinë në përmbushje të objektivit të veprimtarisë së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregullues në lidhje me liçensimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuar.

Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria "Express 24" Sh.p.k zbaton standartet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligshmërisë.

## II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

### NENI 8 Kapitali themeltar

8.1. Kapitali themeltar i shoqërisë "Express 24" Sh.p.k është 100.000 (njqindemije ) Leke.

8.2. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njqindemije ) Leke dhe është i ndarë në **3 (tre ) kuota .**

- 1.Ortaku Klajd Mulhaxhia zoteron **34 % te kapitalit themeltar (1 kuot)**
- 2.Ortaku Bledar Sulejmani zoteron **33 % te kapitalit themeltar (1 kuot)**
3. Ortaku Ervin Shameti zoteron **33% te kapitalit themeltar ( 1 kuot)**

8.3. Çdo pjesë e kapitalit themeltar i jep të drejtën e një vote zotëruesit të saj.

8.4. Ortaku i Shoqërisë "Express 24" Sh.p.k përgjigjet për detyrimet ndaj të tremeve deri në vlerën e kontributit të tyre në formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

### NENI 9 Transferimi

9.1. Pjesët e kapitalit mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakeve.

9.2. Transferimi i pjesëve të kapitalit tek persona të tjerë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri iu nënshtrohet këtyre rregullave:

a) Transferuesi ose Ortaku transferues, duhet të njoftojë Ortaket e tjera për numrin e pjesëve që do të transferohen, çmimin e shitjes në rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresën e personit të cilit mendon t'i transferohen pjesët.

b) Transferimi duhet të miratohet nga Ortaket e tjera brenda 3 muajve nga dita e njoftimit. Në rast se Ortaket nuk e kanë bërë të ditur vendimin e tyre brenda afatit 3 muajor miratimi quhet i dhënë.

c) Në rast se Ortaket refuzojnë transferimin, brenda 3 muajve nga data e refuzimit, atëherë ata duhet t'i blejnë pjesët e propozuara për transferim. Çmimi i shitjes është vlera kontabel e pjesëve.

d) Ne rast se Ortaku nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Ortaket e Shoqërisë do të bien dakort nese:

1. pjeset do ti shiten personit te propozuar nga Ortaku transferues me cmimin e rene dakort midis tyre;
2. pjeset do ti shiten nje personi tjetër te tretë me çmimin e rene dakort me kete person , por jo me pak se vlera kontabel e tyre;
3. pjeset do te blihen nga Shoqëria per tu anuluar, ne kuadrin e nje zvogelimi kapitali, ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

9.3. Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurie ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

9.4. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që bashkëshorti, trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi të bëhen ortakë, nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, vetëm pasi të jetë miratuar nga Asambleja sipas kushteve që caktojnë Ortaket. Kushtet për ortakun e ri nuk mund të jenë më pak të favorshme se ato të caktuara për të tretët për rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, përndryshe Vendimi i Asamblesë është i pavlefshëm.

9.5. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

#### **NENI 10 Zmadhimi i Kapitalit**

10.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakut , ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", ne baze te raportit te Administratorit te Shoqërise.

10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.

10.3. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve në para, te gjitha pjeset e reja të Kapitalit duhet te nenshkruhen dhe te shlyhen teresisht nga Ortaku. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesit në Bankë per llogari te Shoqërise "Express 24" Sh.p.k.

#### **NENI 11 Zvogelimi**

11.1. Zvogelimi i kapitalit mund te kryhet me vendim te ortakut, ne perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

11.2. Zvogelimi i prek Ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata zotërojne.

### **III. MARRJA E VENDIMEVE , ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

#### **NENI 12 Organet drejtuese**



12.1. Organet drejtuese të Shoqërisë "Express 24" Sh.p.k. janë:

- a) Asambleja e Ortakëve në të cilën marrin pjesë Ortaku i Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratori.

### NENI 13

#### Asambleja e Ortakeve dhe konsultimet ndermjet Ortakeve

13.1. Vendimet merren nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve merr vendime për çeshtjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çeshtjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

13.2. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjister të posaçëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë "Express 24" Sh.p.k.

13.3. Përveç rasteve të miratimit të llogarive vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asambleja mund të marrë vendime edhe me anë të konsultimit me shkrim të ortakeve. Administratori ka të drejtën e zgjedhjes së formës së marrjes së vendimit ndërmjet mbledhjes së Asamblesë ose konsultimit me shkrim.

13.4. Çdo mbledhje e Asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, si dhe çdo konsultim me shkrim i kryer në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Megjithatë anulimi nuk ka vlerë, në rast se të gjithë ortakët kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar si dhe kanë miratuar projektvendimin e propozuar.

### NENI 14

#### Marrja e vendimeve

14.1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i kuotave të kapitalit që zotëron, ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe në vendimet e asamblese dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit themeltar që ai zotëron.

14.2. Kur Asambleja e Ortakëve është thirrur për të marrë një vendim për një marrëveshje midis Shoqërisë dhe Ortakut, ky i fundit nuk mund të marrë pjesë në votim dhe vendimi merret nga Ortaku ose Ortakët e tjerë të Shoqërisë.

14.3. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet në këto mbledhje nga një ortak tjetër ose nga një mandatmbajtës i cili mund të votojë në emër të atij që përfaqëson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm, por jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asamblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera, që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.

14.4. Në mbledhjet e Asamblesë ose në konsultimet me shkrim vendimet merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortakët konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.



**Neni 15**  
**Zhvillimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve**

15.1. Asambleja e Ortakëve i zhvillon mbledhjet ne seline e Shoqerise ose ne nje vend tjetër te caktuar nga vete Ortakët.

15.2. Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt jo me pak se dy herë në vit, dhe njëra prej mbledhjeve zhvillohet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar. Asambleja mund te thirret ne çdo kohe me kerkesen e:

- a. nje apo disa ortakeve qe perfaqesojne jo më pak se 5% te kuotave te kapitalit themeltar,
- b. ekspertit kontabel te autorizuar. Përpara se të thërresë Asamblenë, eksperti kontabël i autorizuar njofton administratorin me letër rekomande.;
- c. te administratorit. Në qoftë se janë disa administratorë, e drejta e thirrjes së Asamblesë mund t'i besohet ose secilit administrator ose të gjithë administratorëve që të veprojnë bashkarisht.;
- d. te likujduesit.

15.3. Administratori iu njofton me leter rekomande, te gjithë ortakeve mbledhjen e Asamblese, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen dhe rendin e dites se mbledhjes. Duke filluar nga data e komunikimit, çdo ortak ka të drejtë të paraqesë pyetje me shkrim, të cilave Administratori duhet t'u përgjigjet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.

15.4. Kur Administratori ose eksperti kontabël i autorizuar kanë refuzuar të mbledhin Asamblenë, secili nga Ortakët mund t'i drejtohet Gjykatës për caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e Asamblesë së Ortakëve.

15.5. Asambleja drejtohet nga Administratori ose nga Ortaku që zotëron ose përfaqëson numrin më të madh të pjesëve të Kapitalit. Nëqoftëse dy Ortakë zotërojnë të njëjtin numër pjesësh, drejtimi i mbledhjes bëhet nga Ortaku më i moshuar. Kompetencat, te drejatat dhe detyrimet e Kryetarit të Asamblesë ndaj Shoqerise, rregullohen ne aktin e emerimit të tij.

15.6. Kryetari i Asamblese emeron nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces-verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithë ortaket e pranishem ne mbledhje.

15.7. Proçes-verbali i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve do te permbaje sa me poshte vijon:

- a. Datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes;
- b. Menyren e njoftimit;
- c. Kryetarin e Asamblesë dhe Sekretarin;
- d. Rendin e dites;
- e. Numrin dhe emrat e pjesëmarrësve;
- f. Raportet dhe dokumentet qe jane paraqitur ne mbledhje;
- g. Permbledhjen e diskutimeve të zhvilluara;
- h. Numrin e votave bazuar në pjesët e Kapitalit Themeltar;
- i. Tekstet e projekt-vendimeve te votuar, ata te miratuar dhe ata te hedhur poshte nga Ortakët.

15.8. Votimi kryhet i veçantë për çdo projektvendim dhe nëqoftëse një projektvendim përmban shumë çështje që secila mund të kërkojë një votim të veçantë, atëherë çdo ortak mund të kërkojë ndarjen e projektvendimit në disa projektvendime të veçantë.



15.9. Votimi eshte ne parim i hapur, por mënyra e votimit përcaktohet në marrëveshje ndërmjet ortakëve. Me kërkesë të një ose disa ortakëve që përfaqësojnë me shumë se gjysmen e pjesëve të kapitalit, votimi zhvillohet i fshehtë.

15.10. Te gjitha vendimet e shoqërisë regjistrohen në një liber të veçantë që mbahet në selinë e Shoqërisë, i cili duhet të jetë i numërtuar dhe i vulosur.

## **Neni 16** **Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve**

16.1. Jane në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- a. ndryshimit të Statutit;
- b. riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi;
- c. linjat baze për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë;
- d. zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vetë shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- e. miratimi i llogarive, raportit vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel të autorizuar;
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave të reja;
- g. marrja hua, lenia peng apo çdo barre tjetër siguruese;
- h. hapja e një aktiviteti të ri ekonomik;
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit të Asamblesë;
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel të autorizuar;
- l. blerja e pasurive të paluajtshme;
- m. blerja e aksioneve, certifikatave apo titujve të shoqërive të tjera tregtare, apo e çdo lloj instrumenti financiar;
- n. Prishjen e shoqërisë në rast se humbjet janë me të mëdha se gjysma e kapitalit;
- o. Shnderimin e Shoqërisë në një formë tjetër;
- p. si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asamblesë.

## **NENI 17** **Administratori i Shoqërisë**

17.1. Shoqëria administrohet nga 1(një) Administrator, person fizike që mund të jetë ose jo ortak të Shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Klajd Mulhaxhia me nr ID I 60807051 B**

17.2. Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqërinë "**Express 24**" Sh.p.k. në përputhje me ligjin « Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare », këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

17.3. Në rastet kur Administratori është Ortak i Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k. në baze të nenit 5 të Kodit Shqiptar të Punes, detyra e Administratorit nuk do të rregullohet nga kontrata e punës.

17.4. Administratori i Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k. një herë në tre muaj, duhet t'i paraqesë Asamblesë së Ortakëve, për kontroll dhe verifikim, raportin mbi administrimin e Shoqërisë.



17.5. Administratori i Shoqërisë "**Express 24** Sh.p.k brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar te Shoqerise, duhet t'i paraqese Asamblesë së Ortakëve per kontroll dhe verifikim, raportin financiar vjetor dhe bilancin e Shoqerise.

17.6. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes së vitit financiar deri në datën e hartimit të këtij raporti.

17.7. Administratori duhet t'i transmetoje Asamblesë së Ortakëve te gjithë korrespondencen e mbajtur me Ekspertet Kontabel te Autorizuar te Shoqerise.

## NENI 18

### Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit

18.1. Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një periudhe **3 (tre)vjecare**.

18.2. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit mund të përcaktohet nga Ortakët sa herë që bëhet emërimi i Administratorit dhe do të parashikohet në aktin e emërimit. Në mbarim të afatit të parashikuar, Administratori mund të riemërohet. Në mungesë të parashikimeve kohore në aktin e emërimit, Administratori do të ushtrojë detyrat e tij për të gjithë periudhën e aktivitetit të Shoqërisë.

18.3. Administratori i Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k mund te shkarkohet para perfundimit te mandatit ne rastet e meposhtme:

- a. Nese është shpallur fajtor me vendim te formes se prere te gjykates per kryerjen e nje vepre penale qe ka lidhje me veprimtarine ekonomiko-financiare;
- b. Nese vertetohet se ka shperdoruar fondet e Shoqerise;
- c. Ne rast se me vendim te gjykates kompetente i eshte kufizuar apo hequr zotesia per te vepruar;
- d. Nëse është ndaluar për të administruar dhe drejtuar shoqëritë;
- e. Në çdo rast tjetër që pengon në mënyrë të zgjatur Administratorin të kryejë funksionet e tij;
- f. Si dhe për çdo arsye të drejtë që vlerësohet nga Asambleja e Ortakëve.

18.5. Konsiderohet arsye e drejtë për shkarkimin e Administratorit:

- a. refuzimi i vazhdueshëm i Administratorit për t'iu nënshtruar rregullave të ligjit dhe dispozitave të Statutit lidhur me miratimin vjetor të llogarive dhe me të drejtën e ortakëve për t'u informuar;
- b. administrimi i keq financiar i Shoqërisë **Express 24** " " Sh.p.k;
- c. pavarësisht nga gabimet e Administratorit, do të konsiderohet arsye e drejtë për shkarkimin e Administratorit fakti i humbjes së besimit dhe marrëdhëniet jo të mira me Ortakët, bankierët dhe Administratën publike;
- d. Administratori ka ndjekur një politikë personale në administrimin e Shoqërisë dhe nuk ka pranuar sugjerimet e vazhdueshme të Ortakëve për mirëadministrimin e Shoqërisë.





18.6. Me kërkesë Ortakut të Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k. Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata për shkelje të ligjit ose të Statutit.

18.7. Efektet e Vendimit për shkarkimin e Administratorit fillojnë nga data e marrjes së tij dhe vendimi nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

#### **NENI 19** **Dorëheqja e Administratorit**

19.1. Administratori qoftë Ortak ose jo, mundet në çdo kohë të japë dorëheqjen, por nëse dorëheqja bëhet pa arsye të drejtë, Shoqëria "**Express 24**" Sh.p.k mund të kërkojë dëmshpërblim financiar në masën që është dëmtuar nga kjo dorëheqje.

19.2. Administratori që kërkon të japë dorëheqjen duhet të njoftojë me letër rekomande me kthim përgjigje Administratorët e tjerë si dhe të gjithë Ortakët.

19.3. Njoftimi i dorëheqjes e bën dorëheqjen përfundimtare dhe Administratori nuk mund të rimarrë funksionet e tij.

#### **NENI 20** **Kompetencat e Administratorit**

20.1. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në emër dhe për interes të Shoqërisë "**Express 24** Sh.p.k me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve.

20.2. Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë para të tretëve dhe të gjitha vendimet manaxheriale të Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k duhet të nënshkruhen të pakten nga Administratori.

20.3. Asambleja e Ortakëve mund t'i japë autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve të caktuara ose lidhjen e kontratave të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë.

20.4. Megjithatë, pa përjashtuar masa të tjera më të detajuara dhe rregullore të brendshme të Shoqërisë, veprimet dhe kompetencat e mëposhtme Administratori mund t'i kryejë vetëm me autorizim paraprak të Asamblesë së Ortakëve:

- a) përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Shoqërisë "**Express 24**" Sh.p.k ;
- b) kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe veprimet apo operacionet e tjera që do të kërkonin ndryshimin e buxhetit fillestar të Shoqërisë;
- c) hapja e veprimtarive ose e njësive të reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht a pjesërisht e veprimtarive dhe njësive të Shoqërisë;
- d) blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të Shoqërisë;



- e) themelimi nga ana e Shoqërisë " **Express 24** " Sh.p.k të shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar;
- f) marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera, kur këto të fundit tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë;
- g) përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;
- h) si dhe ato vendime ose masa që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e Shoqërisë.

20.5. Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gëndon të dobishme tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në aktivitetin e Shoqërisë.

20.6. Administratori mund t'u delegojë personave të tjerë ortakë ose jo, disa nga kompetencat e tij për ushtrimin e funksioneve të veçanta. Administratori nuk mund të delegojë tërësinë e kompetencave të tij.

## **NENI 21**

### **Administrimi i Shoqërisë nga disa Administratorë**

21.1. Asambleja e Ortakëve në çdo moment, mund të vendosë që Administrimi i Shoqërisë " **Express 24** " Sh.p.k të kryhet nga disa Administratorë.

21.2. Në këtë rast, maredhëniet midis administratorëve, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit mund të rregullohen në rregullore të veçantë ose të parashikohen në vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

21.3. Asambleja e Ortakëve mund të kufizojë kompetencat dhe të drejtat e secilit Administrator dhe/ose të vendosë që ata të ushtrojnë kompetencat e tyre me vendime të përbashkëta dhe të drejtojnë firmat të përbashkëta ose secili prej Administratorëve të ketë kompetencat të veçanta.

## **NENI 22**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

22.1. Në marrëdhënie me të tretët, Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë " **Express 24** " Sh.p.k

22.2. Çdo ortak joadministrator ka të drejtë dy herë në vit t'i paraqesë me shkrim Administratorit disa pyetje për ato probleme që mendon se përbëjnë shqetësim për veprimtarinë e shoqërisë. Për pyetjet e bëra Administratori është i detyruar t'i përgjigjet me shkrim.

22.3. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e administrimit të Shoqërisë të kryera nga Administratori edhe kur këto veprime nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Shoqëria " **Express 24** " Sh.p.k nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë fakt në rrethanat e krijuara.



- 22.4. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj Shoqërisë apo të tremeve për:
- shkelje të ligjeve;
  - për shkelje të Statutit, apo
  - për fajë të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

**IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**  
**NENI 23**  
**Viti Financiar**

24.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor dhe përputhet me vitin kalendarik. Përfundimisht viti i parë fillon në ditën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykatës dhe përfundon në 31 dhjetor.

**NENI 24**  
**Llogarite Vjetore**

25.1. Me mbylljen e vitit financiar, administratori i shoqërisë bën inventarin dhe llogarite vjetore në përputhje me legjislacionin mbi kontabilitetin.

25.2. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet nga Asambleja e Ortakëve brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

**NENI 25**  
**Fitimi**

26.1. Fitimi ose kur është rasti humbja e ushtrimit financiar përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, në pajtim me rregullat e parashikuara në legjislacionin mbi kontabilitetin.

26.2. Fitimi i ushtrimit mund të destinohet për të krijuar e plotësuar rezervat e shoqërisë ose për t'ju shpërndarë ortakëve.

26.3. Në rastin e një humbjeje Asambleja që miraton llogarite duhet të vendosë për mbulimin e humbjes.

**NENI 26**  
**Rezervat**

27.1. Rezerva e domosdoshme nuk mund të përdoret as për t'ju shpërndarë ortakëve as për shlyerjen apo riblerjen e pjesëve nga shoqëria.

27.2. Ajo përdoret në rastin e humbjeve kur këto humbje nuk mund të mbulojnë (thithen) nga rezerva të tjera.

27.3. Në rastin kur shoqëria nuk ka të mbartura humbje nga ushtrimet e mëparshme masa e fitimeve mbi të cilën llogaritet rezerva e domosdoshme është shuma e fitimit të ushtrimit financiar të mbyllur.



27.4. Ne rastin kur shoqeria ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimeve te mbetura pas zbritjes se humbjeve te mbartura.

27.5. Heqja nga fitimet per krijimin e rezerves ose per te ushqyer rezerven e domosdoshme eshte te pakten 1/20 e mases se fitimeve. Kjo heqje nuk eshte e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

#### **NENI 27 Shperndarja e Fitimit**

28.1. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i ushtrimit perkates te cilit:

- a. i zbriten humbjet e mbartura dhe shumat qe hiqen per rezervat
- b. i shtohen fitimet e mbartura.

28.2. Fitimet ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitalit themeltar qe ka secili ortak.

#### **NENI 28 Dividentet**

29.1. Asambleja e pergjithshme mund te vendose shperndarjen e dividendeve vetem pasi:

- a. nga njera ane te kete miratuar llogarite vjetore;
- b. nga ana tjeter te kete percaktuar shumen qe do te shperndahet.

#### **NENI 29 Paradheniet per dividendet**

30.1. Paradhenie per dividente jane shumat qe u jepen ortakeve perpara miratimit te llogarive vjetore dhe caktimit nga asambleja te dividendit perfundimtar. Keto paradhenie jane te ligjshme, por duke respektuar kerkesat ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe konkretisht me kusht qe :

- a. shoqeria vec rezerves se domosdoshme e kete ne dispozicion rezerva me nje shume te pakten te njejte me paradheniet e shperndara, ose qe nje raport vertetimi i bere nga nje ekspert kontabel i autorizuar te beje fitime neto me te medha se shuma e paradhenieve.
- b. shperndarja e paradhenieve duhet te vendoset nga administratori i cili duhet te caktoj edhe daten e kthimit.

#### **NENI 30 Vendimi per humbjet**

31.1. Ne rastin kur rezultati i ushtrimit te mbyllur eshte humbje, asambleja e pergjithshme mund te vendose:

- a. ose mbartjen e kesaj humbjeje ne ushtrimin e ardhshem, duke kaluar ne nje llogari te vecante "humbje te mbartura"
- b. ose pastrimin e saj nga rezervat, duke perfshire edhe rezerven e domosdoshme.

31.2. Vetem kur humbjet e mbartura te jene pastruar teresisht mund te rifilloje shperndarja e fitimeve.

#### **NENI 31 Detyrimi per te perballuar humbjet**



Detyrimi per te perballuar humbjet eshte perpjestimor me kontributet e seicilit ortak.  
Cdo marreveshje qe parashikon perjashtimin e nje ortaku nga perballimi i humbjeve eshte i pavlefshem.  
Nese shoqeria prishet dhe vihet ne likuidim, atehere likuidatori eshte i detyruar te shlyeje te paret kreditorët e saj.

**NENI 32**  
**Publikimi**

33.1. Cilido qofte vendimi i marre nga ortaket, prishje apo vazhdimi i shoqerise, ai duhet te publikohet ne nje gazete te autorizuar per publikime ligjore dhe te regjistrohët ne regjistrin tregtar.

**NENI 33**  
**Bilanci**

34.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes.

**V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI**

**NENI 34**  
**Humbja e gjysmes se kapitalit.**

35.1. Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel rezultojne me te uleta se gjysma e kapitalit themeltar, atehere konsultimi i ortakeve eshte i detyrueshem.

35.2. Ortaket duhet te vendosin, mbi mundesine e prishjes se shoqerise brenda 4 muajve nga data e miratimit te llogarive qe pasqyrojne kete humbje. Megjithate edhe konsultimi me shkrim midis ortakeve nuk perjashtohet.

35.3. Vendimi merret ne te njejten menyre si per kryerjen e ndryshimeve ne statut.

**NENI 35**  
**Rregullimi i gjendjes**

36.1. Neqofte se ortaket kane vendosur ta mbajne shoqerine atehere ata kane nje afat prej nje viti nga data e mbylljes se ushtrimit kur eshte konstatuar gjysma e humbjes se kapitalit per te plotesuar kapitalet e veta.

36.2. Neqoftese plotesimi i kapitaleve te veta nuk arrihet atehere shoqeria duhet te procedoje ne zvogelimin e kapitalit ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat.

**NENI 36**  
**Likuidimi**





37.1. Shoqeria priset me vendim te Asamblese me unanimitet dhe ne perputhje me dispozitat ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Klajd Mulhaxhia Bledar Sulejmani Ervin Shameti**

Klajd Mulhaxhia  




 Bledar Sulejmani  


Ervin Shameti



Klajd Mulhaxhia

